



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:142920

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726288

AC.nr.908/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj, antarë të kolegjit, çështjen Juridike - Kontestimore të paditësit B. B. nga fshati B., Komuna e M. të cilin me autorizim e ka përfaqësuar Av.N. K. nga M., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S. U. G. A.” sh.a me seli në P. e përfaqësuar nga B. R. nga P. dhe të paditurës BKS, me seli në P. e përfaqësuar nga M. P. nga P., sipas bazës juridike kompensim i dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë- Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 168/16, të datës 05.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurës BKS me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë me numër C.nr.168/16, dt: 05.11.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë-Departamenti i përgjithshëm me aktgjykimin C.nr. 168/16, të datës 05.11.2020, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit B.B. nga fshati B., Komuna e M..
- II. DETYROHET** e paditura B. K. e S., me seli në P., që paditësit B. B. nga fshati B., Komuna e M., t’ia kompensoj dëmin material në shumën prej 498.00 euro me kamatë

prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 05.11.2020, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit B.B. nga fshati B., Komuna e M. ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “S. U. G. A.” sh.a me seli në P..

IV. DETYROHET e paditura B. K. e S. që paditësit Pjesërisht t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore, dhe atë përpilimin e padisë shumë prej 80.00 euro, për 4 seanca gjyqësore në shumë prej 540.00 euro dhe në emër të taksës shumë prej 16 euro në shumë e përgjithshme prej 636.00 euro.

V. REFUZOHEN pjesa tjetër e shpenzimeve të kërkuara nga paditësi në emër të shpenzimeve për 2 seanca në shumë prej 270 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar e paditura B. K. e S.me seli në P.për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe të prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthej në ri vendosje, apo të njëjtin ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në raport me të paditurën.

Paditësit, nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë ankimore, pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve ankimore, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së, konstatoi se:

Ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve BKS me seli në Prishtinë është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B. B. nga M., përmes të autorizuarit të tij, avokat N. K. nga M., me datën 221.09.2016, ka ushtruar fillimisht kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve KS “S.”, për shkak të kompensimit të dëmit material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të datës 04.08.2015, ndërsa me parashtrësën për zgjerimin subjektiv të padisë të datës 29.06.2020, ka zgjeruar padinë edhe ndaj të paditurës B. K.e S.-BKS me seli në P., duke kërkuar kompensimin e dëmit material në shumë prej 498 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

Fillimisht, paditësi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve KS “S.” me seli në P., përmes parashtrësës së datës 21.10.2019, është tërheqë nga padia ndaj të njëjtës, kështu që, si palë e paditur në këtë çështje juridike nga zgjerimi i padisë në aspektin subjektiv ka mbetur vetëm ndaj të paditurës BKS me seli në Prishtinë.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seancat e shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë, ngase sipas nenit II.3 të MOU (Marrëveshjes së Memorandumit) 2006 korrespondentët për trajtimin dhe kompensimin e dëmeve nga aksidenti i ndodhur nga automjeti me tabelat e Shqipërisë, përkatësisht se në aksidentin e kësaj date, në bazë të evidencave të të paditurës, që shkaktari i aksidentit ka qenë me tabela të Shqipërisë me policë valide pranë Kompanisë S. U. G. A., ., gjykatës i ka propozuar që t’ a hudhë poshtë padinë e palës paditëse në mungesë të legjitimitetit pasiv të të paditurës si dhe refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas nxjerrjes dhe administrimit të provave, mbajtjes së seancave gjyqësore, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit deklarimeve të të autorizuarve të palëve ndërgjyqësore dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së vlerëson se: Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga shikimi i raportit të aksidentit datë 04.08.2015 nr. 2015-ED-382 dhe përmbledhja e aksidentit të përpiluar nga oficeri i trafikut, gjykata vërtetohet se shkaktuesi i aksidentit ka poseduar polisën e sigurimit deri me datë 26.03.2016, që vërteton faktin se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka pasur mbulesë siguroese tek Kompania e Sigurimeve S. U. G.- A.

Nga aktvendimi i Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Malishevë - Divizioni i Kundërvajtjes KII.328/2015 të datës 04.07.2016 u vërtetua fakti se i pandehuri gjegjësisht i siguruari i të paditurës është dënuar për kundërvajtje nga neni 42 par.1 të LSKRR-së.

Në bazë të provave të sipërpërmendura në veçanti raportit të policisë në të cilin u konstatua se aksidenti është shkaktuar nga i siguruari i të paditurës fillimisht ‘S. U. G. –A., ndërsa nga shqyrtimi gjyqësorë u konstatua se përgjegjëse në kompensimin e dëmit paditësit është e paditura B. K. e Si. (BKS), pasi që u vërtetua se shkaktimin e aksidentit e ka bërë i siguruari me policë të sigurimit me targa të huaja, për çka në rastin konkret përgjegjësia bie mbi të paditurën këtu BKS dhe mbi bazën e këtyre fakteve, si dhe bazuar në dispozitat ligjore të LMD-së neni 136 par.1 lidhur me përgjegjësinë mbi shkaktimin e dëmit përcaktohet se **“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”** ndërsa lidhur me detyrimin e të paditurës në kompensimin e dëmit material në dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia përcaktohet se **“Dëmshpërblimi nga mjeti motorik i pasiguar me regjistrim të huaj Pala e dëmtuar të cilës i është shkaktuar dëm në territorin e Republikës së Kosovës nga një mjet motorik me regjistrim të huaj i pajisur me dokument ndërkombëtar të sigurimit, sipas nenit 16, të këtij ligji, ka të drejtë t’i parashtrijë kërkesë dëmshpërblimi Byrosë”** ketë përgjegjësi e ka pranuar edhe vetë e paditura BKS nga edhe rezultoi si jo kontestuese baza juridikë e kërkesë padisë, përjashtimisht nga BKS u kontestua kërkesë padia e paraqitur jashtë afatit ligjor. Ndërsa lidhur me lartësinë e shumës së detyrimit të të paditurës në kompensimin e dëmit, gjykata u bazua në faturën e lëshuar

nga DPZ “Vali” Malishevë në të cilën përshkruhet shuma e akorduar në rregullimin e automjetit të aksidentuar, dhe po ashtu gjykata u bazua edhe në faktin se e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e dëmit të shkaktuar.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e të paditurit për siç thekson parashkrimin e padisë mirëpo gjykata këtë pretendim e konsideron si të pabazuar ngase paditësi padinë e ka paraqitur në afatin ligjorë të përcaktuar edhe me dispozitat e LMD-së ,sipas nenit 376 **“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi”**, për çka në rastin konkret gjykata vlerëson se paditësi ka parashtruar padinë brenda afateve ligjore të larte përmendura, kjo edhe duke llogaritur kohën kur paditësi ka kuptuar për personin i cili e ka shkaktuar dëmin për çka në këtë rast edhe paditësi me datë 29.06.2020 e zgjeron padinë ndaj këtu paditurës BKS.

Gjykata e Konstatoj si të tërhequr padinë e paditësit ndaj të paditurës „S,, si në piken III të dispozitiv të këtij Aktgjykimi pasi që paditësi përmes të autorizuarit të tij e ka tërhequr padinë gjatë seancë së datës 21.10.2019, dhe në anën tjetër duke marrë për bazë se e paditura Sigal në vazhdimësi e ka kundërshtuar kërkesë padinë e paditësit si gjatë seancave dhe përmes përgjigjes në padi të datës 05.04.2019 ku i ka propozuar gjykatës që të refuzohet kërkesë padia e paditësit apo të tërhiqet nga vetë paditësi, e që në këtë rast gjykatë konsideron se e paditura pajtohet me tërheqjen e padisë andaj edhe nuk u ftua që të deklarohet, kështu që edhe vendosi andaj konform nenit 261 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e detyroi të paditurën që paditësit t’ia paguajë, dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 80.00 euro, për përfaqësim për katër seanca gjyqësore shumë prej 540.00 euro (nga 135 euro për seancë) dhe në emër të taksës shumë prej 16 euro, në shumë e përgjithshme prej 636 euro, shpenzime këto si të nevojshme për këtë çështje, ndërsa gjykata i refuzoi shumat tjera mbi shumat e kërkuara në emër të shpenzimeve per 2 seanca në shumë prej 270 euro, pasi që këto ishin të pa nevojshme. Gjykata për shpenzime vendosi në këtë mënyrë bazuar në tarifatat e odës së avokatëve dhe dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimoren neni 453 par.1 përcaktohet se **“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”** .

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382, paragrafit 2 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, pika n) të pretenduara nga pala ankuese, gjendja

faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se zgjerimi i padisë së paditësit ndaj të paditurës BKS është bërë pas kalimit të afatit 5 vjeçar dhe kërkesa e të njëjtit në raport me BKS-në është e parashkruar, kjo për faktin se nga provat në shkresat e konstatohet se fillimisht paditësi padinë e ka drejtuar ndaj KS "S", duke menduar se e njëjta e mbulon sigurimin e kompensimit në rastin konkret, dhe vetëm pasi që, është konstatuar ky fakt, paditësi me tu njoftuar se KS "S", nuk ka legjitimitet pasiv, atëherë, brenda afatit objektiv 5 vjeçar, ka ushtruar padi kundër të paditurës BKS ngase dëmi ka ndodhë me datën 04.08.2015, ndërsa zgjerimi i padisë është bërë me datën 29.06.2020, ndërsa sa i përket pretendimit të të paditurës se në rastin konkret paditësi ka qenë në dijeni për dëmin dhe personin sipas nenit 357 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 dhe ka kaluar afati subjektiv 3 vjeçar për ushtrimin e kërkesës për kompensimin e dëmit, në rastin konkret ky pretendim rezulton i pa bazuar, ngase paditësi edhe pse ka qenë në dijeni për dëmin e shkaktuar, i njëjti në raport me të paditurën BKS nuk ka qenë në dijeni se e njëjta mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia mbulon kompensimin e dëmit, dhe në rastin konkret paditësi dijeninë e ka marrë brenda afatit objektiv 5 vjeçar, ashtu që, edhe padinë e ka ushtruar brenda afatit ligjor, dhe rrjedhimisht mbi bazën e nenit 19 par.1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-118, e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar material në automjetin e paditësit Audi A5 me tabela të huaja të rexhistrimit XXXXX, dhe duke iu referuar provave në shkresat e lëndës, konstatohet se dëmi material që paditësit i është shkaktuar në automjetin e tij me rastin e aksidentit është shuma totale prej 498 euro, prandaj, në kuptim të nenit 136 par.1 në lidhje me nenin 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 e paditura detyrohet t'ia paguajë paditësit shumën e kompensimit si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, dt: 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e nxjerrjes së aktgjykimit 05.11.2020, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata të vendosë për themelësinë e kërkesëpadiisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, ashtu që, bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së, gjeti se drejtë është vendosur edhe për shpenzimet e procedurës.

Numri i lëndës: 2019:142920
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726288

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe nenin 200 e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 908/21, data 20.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka